



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE
INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 720 Prot.

Tiranë, më 20.1.2020

URDHËR

Nr. 67, datë 20.1.2020

PËR

**“MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS TË ILDKPKI
(I RISHIKUAR)**

Në zbatim të neneve 4, 5, 6, 7, 19 të ligjit nr. 119, datë 18.9.2014, “Për të drejtën e informimit” (LDI) dhe pikës 2 të nenit 42 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Miratimin e Programit të Transparencës së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, bashkëlidhur këtij urdhëri. (përkatësisht shtojca A).
2. Përditësimin e Programit të Transparencës, në përputhje me nenin 4 dhe pikën 2 të nenit 19, të LDI, me qëllim:
 - a. garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;
 - b. vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;
 - c. modelet e miratuara për kategorinë e autoritetit publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.
3. Publikimin e Programit të Transparencës në faqen zyrtare të internetit të ILDKPK www.ildkpk.al, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës” dhe në mjediset e pritjes së publikut.



ILDKPKI

Rr. “Reshit Çollaku”, Tiranë, Shqipëri, Tel. + 355 42 259 461, www.ildkpk.al info@hidaa.gov.al

